



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Deliverty	27-01-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	1040/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1188/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1188/2022 të datës 01.08.2022 të parashtruar nga ankuesi _____, me adresë rruga _____ në Komunën e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit /Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në çështjen juridike "kontestimi konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1188/2022 e datës 14.12.2022, e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi përgjigjia në ankesë me numër Ref: 003/0-1/KPMM e datës 13.12.2022 e nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ përmes e-mailit zyrtar, me datën 14.12.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 8046/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në ankesë të datës 13.12.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (tutje KPMM),

për refuzimin e ankesës së datës 09.12.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën "Kryeinspektor i Minerave" në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, me pretendimet ankimore për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike me vendimin Nr.Ref:003/0-1/KPMM të datës 05.12.2022 dhe mos përgjigjen në pikën 2.8 të ankesës së tij të datës 09.12.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 22.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ndërsa Këshilli me datën 10.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.1188/2022 e datës 14.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref:003/0-1/KPMM të datës 05.12.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në KPMM; Ankesën e ankuesit të datës 09.12.2022 e parashtruar tek Njësia e Personelit në KPMM; Përgjigjen në ankesë me numër Ref:003/0-1/KPMM të datës 13.12.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të KPMM-së; Vendimin me numër Ref: 00370-1/KPMM të datës 10.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të KPMM-së; Diplomën e ankuesit me numër Nr.602 të datës 07.12.2022; E-mailat zyrtar të datës 14.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Përgjigjen në ankesë të datës 10.01.2023 nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Aplikacionin e ankuesit të datës 27.10.2022; Certifikatën e ankuesit të datës 25.05.2010; Certifikatën shëndetësore të datës 24.10.2022; Certifikatën me numër Prot.Nr.02/2020; Shkresën zyrtare të datës 16.11.2019; Shkresën lidhur me aspektet teknologjike të ri kultivimit të zonës së degraduar nga vetëndezja e qymyreve në Mirash; Certifikatën e datës 5-7.06.2019; Certifikatën e datës 01-03.2018; Certifikatën e datës 13-16.09.2018; Certifikatën nga BKC; Certifikatën nga EFEE; Tabelën e matjeve të realizuara në terren për të përcaktuar sasisë e shfrytëzuar në mënyrë ilegale 01.01.2022-31.12.2022; Certifikatën e datës 19-20.05.2017; Certifikatën e datës 17-18.11.2016; Certifikatën e datës 10-11.10.2019; Certifikatën e datës 29-30.03.2016; Certifikatën e datës 10.10.2013; Certifikatën e datës 25.05.2010; Punim seminarik për periudhën prill 2019; Certifikatën me numër No.5406 të datës 06.06.2008; Deklaratën e datës 27.10.2022; Vërtetimin e datës 14.06.2022; Certifikatën nga gjykata me numër PN.NR/KR.Br 12006/22 të datës 16.06.2022; Diplomën me numër Nr.59 të datës 16.03.2012; Kopjen e letërnjoftimit; Letrën e motivimit të datës 27.10.2022; Vërtetimin e datës 11.02.2004; Kartelën e ankuesit nga KEK; Vërtetimin me numër Ref:003/0-1/KPMM të datës 24.12.2020; Vendimin Nr.Protokolli 59 të datës 01.12.2015; Kartelën e ankuesit nga KEK; Referencën e datës 28.12.2020; Shkresën e ankuesit të datës 31.10.2022; Pasqyrën e trustit për periudhën 31.12.2003-21.10.2022; Vërtetimin me numër Nr.1161/264 të datës 25.10.2022; Formularin e vlerësimit të datës 28.01.2021; Vlerësimin e performances në punë për vitin 2019 të datës 02.03.2020; Kopjen e konkursit të datës 27.09.2022 me numër RN00010033; Listën e

aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin e datës 06.12.2022; Ankesën e ankuesit të datës 05.12.2022; E-mailat zyrtar të datës 13.12.2022, 09.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me datën 27.10.2022 ka hapur konkursin me numër Reference RN00010033 për pozitën *Kryeinspektor i Minierave* në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, ku është përcaktuar afati për aplikim nga data 27.10.2022 deri me datën 03.11.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesi i cili në bazë të Vendimit numër Ref:003/0-1/KPMM të datës 05.12.2022 është njoftuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, lidhur me refuzimin e aplikacionit pasi që i njëjti nuk i ka bashkangjitur aplikacionit dëshmitë e kërkuara sipas konkursit lidhur me arsimimin e kërkuar.

Ankuesi me datën 13.12.2022 përmes e-mailit zyrtar drejtuar Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore ka deklaruar se certifikata ka qenë e deponuar në KPMM dhe ka kërkuar nga kjo e fundit sqarimin lidhur me atë se pse në refuzimin para 4 muajve nuk i është shkruar se është mangu kjo pikë. Ndërsa kjo e fundit përmes e-mailit zyrtar të datës 13.12.2022, ka sqaruar këtë situatë duke deklaruar se certifikata apo diploma e ankuesit nuk ka qenë pjesë e dosjes personale në KPMM, duke e udhëzuar të njëjtin që ka të drejtë ankese në afat prej pesë (5) ditësh tek Njësia përgjegjëse. Ankuesi me datën 09.12.2022 ka parashtruar ankesë tek Zyra e Personelit në KPMM kundër vendimit të datës 05.12.2022 për refuzimin e aplikacionit, ndërsa kjo e fundit me datën 13.12.2022 ka kthyer përgjigjen në ankesë me numër Ref:003/0-1/KPMM, me ç' rast e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 09.12.2022 dhe e ka udhëzuar të njëjtin për parashtrimin e ankesës brenda afatit prej tetë (8) ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin në Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në ankesë nga Njësia e Burimeve Njerëzore, për pozitën *Kryeinspektor i Minierave* në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, pretendon që diploma e magistraturës është nga departamenti i xehetarisë dhe se përmbush kushtin e dispozitës së nenit 68, pikën 1.1 të Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale, i njëjti thekson se refuzimi i aplikacionit të tij ka rezultuar si i qëllimshëm, ngase sipas tij po ti tregohej me vendimin e datës 05.12.2022 se i mungon dokumenti i njëjti do ta rregullonte këtë problem.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se në konkursin e shpallur 27.10.2022, për pozitën "*Kryeinspektor i minierave*" në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, kriteret formale të konkursit kanë qenë:

- *Diplomë/a të studimeve universitare Drejtimi i Xehetarisë me të paktën 240 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to. Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, duke u bazuar në dispozitat e nenit 78 paragrafit 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve për këtë pozitë dhe në bazë të Vendimit me numër Ref:003/0-1/KPMM të datës 10.06.2022, ankuesi është njoftuar që i është refuzuar aplikacioni pasi që i njëjti nuk i ka bashkangjitur aplikacionit dëshmitë e kërkuara lidhur me arsimimin e kërkuar tek pika e 3 që ka të bëjë me kërkesat e përgjithshme formale dhe pika e 6 që ka të bëjë me fushën e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen sipas konkursit.

Me qëllim të shqyrtimit të drejtë të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe provave të bashkangjitura në lëndë me rastin e aplikimit për pozitën e lartcekur, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi posedon Diplomën me Nr. 59 të datës 16.03.2012 të lëshuar nga Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë i Universitetit të Prishtinës me të cilën dëshmohet se me datën 29.09.2011 ka përfunduar studimet pasdiplomike dhe ka mbrojtur tezën e magjistraturës me temën “Zgjidhja e parametrave optimal për operim në palosjet e jashtme-Vasilevë” dhe me këtë ka marrë titullin **Magjistër i shkencave teknike**, ndërsa sa i përket diplomës lidhur me përfundimin e studimeve themelore, i njëjti me rastin e aplikimit lidhur me pozitën për të cilën është zhvilluar procedura e rekrutimit, nuk ka bashkangjitur në dosjen e tij bazuar në përgjigjen e organit të punësimit dhe si rezultat i mungesës së saj të njëjtit i është refuzuar aplikacioni.

Kolegji gjatë analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga ana e ankuesit me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill, ka konstatuar se i njëjti ka bashkangjitur Diplomën me numër Nr.602 të datës 07.12.2022, me të cilën dëshmohet se me datën 21.06.1995 ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë dhe me këtë rast i njëjti ka marrë titullin *Inxhinier i diplomuar i xehetarisë*, mirëpo që e njëjta diplomë nga ana e ankuesit nuk është bashkangjitur me rastin e aplikimit për pozitën e lartcekur tek Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ngase data e lëshimit të kësaj diplome figuron se është 07.12.2022 dhe rrjedhimisht nisur nga ky fakt Kolegji vlerëson se ankuesi të njëjtën e ka marrë pas mbylljes së konkursit.

Bazuar në shkresat e lëndës si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesi, Kolegji ka konstatuar se i njëjti nuk ka mundur të dëshmojë që ka përvojën profesionale lidhur me përfundimin e studimeve themelore për fushën e arsimimit të kërkuar në pozita drejtuese siç parashihet me kriteret e konkursit dhe të parapara me Shtojcën Nr.1/1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë 1 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale duke u bazuar në kriteret e përcaktuara, me rastin e verifikimit paraprak për rastin e ankuesit, ka vepruar në bazë të kompetencave të saj të përcaktuara me nenin 11 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me nenin 40 paragrafin 5 nën paragrafin 5.1 dhe paragrafin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 8 paragrafin 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.

01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: "2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliken me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional".

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që Njësia e Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, me rastin e mos përfshirjes së ankuesit në mesin e kandidatëve që kanë plotësuar kushtet e konkursit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartcekura dhe kriteret e konkursit, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit në këtë drejtim janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1188/2022, datë 27.01.2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.
- Arkivit të KPMSHCK-së.